



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3197/2020  
Data: 15.06.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.05.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit të komunës për vitin 2020.
3. Shqyrtimi i informatës mbi mbrojtjen e mjedisit.
4. Shqyrtimi i Planit Zhvillimorë Komunal për vitin 2020-2028.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- para se të fillojmë me diskutimet për rendin e punës kërkoj nga kryetari i komunës që të prononcohet sa i përket pikave të rendit të punës.

**Rufki Suma** thekson:- nga pesë pikat e rendit të punës të cilat janë paraparë në planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2020 nuk kanë mundur me u përgatitur materialet për shkak se kanë lidhshmëri me nivelin qendrorë. Për rishikimi të buxhetit të komunës për vitin 2020 nuk dihet sa a do të bëhet për shkak të Qeverisë dhe nëse niveli qendrorë nuk dërgon shkresë për me bërë rishikim ne nuk mund të bëjmë por e kemi vetëm mundësinë tjetër në muajin korrik që me bërë ridestininim të mjeteve financiare në bazë të përqindje që e lejon ligji. Pika e tretë e rendit të punës ka të bëjë me informatën mbi mbrojtjen e mjedisit ka lidhshmëri me raportin qendrorë i cili përpilohet prej të gjitha komunave dhe raporti nuk është bërë për shkak të pandemisë. Pika e katër ka të bëjë me Planin Zhvillimorë Komunal për vitin 2020-2028 dhe prej kohës që ishim në Mavrovë grupi punesë është dashur me u takuar edhe disa herë grupet punuese por për shkak të pandemisë nuk është mbajtur asnjë takim dhe nuk mund ta përcjellim për shkak se nuk është gati. Unë mendoj që për mbledhje të kuvendit të komunës me u diskutuar pikat të cilat ishin të planifikuar në bazë të planit të punës dhe materialet të cilat janë gati, mirëpo duhet të hynë edhe një pikë e rendit të punës për çështjen e koronavirusit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse miratohen këto pika të rendit të punës besoj që jemi në kundërshtim ligjorë dhe më mirë do të ishte që procedojmë me ndonjë pikë të rendit të punës të cilën mund ta shqyrtojmë në mënyrë që të procedojmë me tri pika të rendit të punës dhe njëra të jetë për çështje të koronavirusit. Nuk është mirë që të procedojmë për kuvend me këto pika të rendit të punës duke e ditur që për këto pika nuk ka material me përcjell për kuvend pasi që varet prej nivelit qendrorë.

**Kryesuesi** thekson:- pasi që kryetari i komunës i dha sqarimet për pikat e rendit të punës për mbledhje të kuvendit të komunës diskutohen pikat të cilat kanë kaluar në KPF në mbledhjen e tretë dhe në mbledhjen e katërt. Propozoj që në këtë mbledhje të procedojmë me tri pika të rendit të punës. Propozim e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.**
3. **Të ndryshme.**

### 1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. **Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket kësaj pike të rendit të punës në komunën tonë deri më tani ishin vetëm shtatë raste. Pas një muaji është bërë rritimi dhe gjashtë persona kanë dalë negativ dhe një pozitiv dhe pas dhjetë dite ju është bërë testi rasti që ka dalë pozitiv por dy ditë radhas ka dalur negativ. Edhe pse testet ju kanë dalur negativ personat janë detyruar me qëndruar edhe dy javë ditë në vet izolim dhe para shtatë dite e kanë kaluar vetizolimën gjashtë të infektuarit, ndërsa rasti i mbetur sot apo nesër do ta kalon vetë izolimin. Organizata “WAMY” ka ndihmuar me 80 pako familjet me nevojë. Zyra e OKB-së- UNMIK-ut ka ndihmuar me 50 pako ushqimore dhe 40 pako higjienike dhe kanë filluar me i shpërndarë. Krahas ndihmave që i kemi shpërndarë te familjet në nevojë kemi dhënë ndihma edhe për ata persona të cilët janë paraqitur se kanë nevojë.

**Nora Xhoni** thekson:- si po shkon procedura e masave të lehtësimit edhe pse mbrëmë fillimisht kanë dalë.

**Rufki Suma** thekson:- nuk ju kanë përmbajtur rekomandimeve qytetarët por është një e mirë që për shkak të muajit ramazan qytetarët nuk po dalin deri në kohë të iftarit. Edhe për policinë ka pas probleme për shkak të vendimeve që janë nga niveli qendrorë sepse vendimi është shpall jo kushtetues nga gjykata kushtetuese.

**Kryesuesi** thekson:-sa i përket dënimeve komunat nuk kanë vepruar njëjtë për shkak se disa komuna kanë shqiptuar dënime për kundërvajtje e disa në vepra penale. Komuna është ngarkuar me shqiptuar dënime në kundërvajtje e që realisht nuk është dashur. Dënimet në kundërvajtje janë zgjedhur në bazë të udhëzimit administrativ ndërsa ligj për pandeminë nuk ka dhe ka hamendje në organe se në çfarë procedure me vepruar.

**3. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:32

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**